



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SHUPSTINA OPSTINE SKENDERAJ	
Nr.	
No.	13- 112/01-0052 847/25
Data.	
Data.	18. 12. 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Inspektion
Direkcija za inspekciju
Directorate for
Inspection

DATE/A:	18/12/2025
PËR/ZA/TO:	Sekretaria e Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arkivit
NGA/OD/FROM	Drejtori i Inspektionit, Valon Haliti
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Plani i Punës i Drejtorisë për Inspektion për Vitin 2026

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

Dhjetor, 2025

HYRJE

Plani i Punës i Drejtorisë së Inspekcionit për vitin 2026 përcakton prioritetet, objektivat, aktivitetet e nevojshme për realizimin e objektivave të caktuara, afatet kohore dhe bashkëpunimin me institucionet relevante që do të ndihmojnë në implementimin efektiv të këtij plani.

Përmes këtij plani, synohet të rritet niveli i zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në përputhje me fushën që mbulojnë sektorët e ndryshëm që veprojnë në kuadër të Drejtorisë së Inspekcionit.

Ky plan pune bazohet në prioritetet e nxjerra nga raportet e punës për vitin paraprak, në nevojat dhe kërkesat e komunitetit, në parregullsitë e evidentuara gjatë vitit të kaluar dhe në obligimet që burojnë nga infrastruktura ligjore që mbulon kjo drejtori.

OBJEKTIVAT

Objektivat kryesore që synojmë të arrijmë gjatë vitit janë:

- ❖ Mbrojtja e konsumatorit,
- ❖ Ruajtja e pronës publike,
- ❖ Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit,
- ❖ Parandalimi i ndërtimit ilegal,
- ❖ Transporti i sigurtë për udhëtarë.

STRUKTURA E INSPEKTORATIT KOMUNAL

Drejtoria e Inspekcionit ka shtatë inspektorë, të ndarë në pesë profile dhe një analist të buxhetit:

- Inspektorët e Tregut (3),
- Inspektori i Komunikacionit,
- Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit,
- Inspektori i Shërbimeve Publike,
- Inspektori i Ndërtimit.

OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA SIPAS PROFILEVE

Në vazhdim, paraqesim në formë tabelare objektivat e punës për secilin sektor të inspektimit, të cilat synohen të realizohen gjatë vitit 2026. Këto objektiva do të shërbejnë si bazë për matjen e performancës së punës së Drejtorisë së Inspektionit në fund të vitit, duke u fokusuar në indikatorë të qartë të suksesit, duke përfshirë raportime periodike dhe vlerësime të aktiviteteve të realizuara.

SEKTORI I TREGUT

Plani i punës në sektorin e tregut për vitin 2026 do të bazohet në ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që trajtojnë aspekte të ndryshme të këtij sektori. Ndërkohë, është e rëndësishme të theksohet se implementimi i këtyre aktiviteteve kërkon bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera dhe përpjekje për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve për t'u përballur me sfida të reja dhe me zhvillimet e shpejta në treg.

Objektivat kryesore për sektorin e tregut në planin e punës për vitin 2026 janë:

- **Ndalimi i ekonomisë informale** - Një nga objektivat më të rëndësishme për këtë vit është adresimi i ekonomisë informale, që përfshin kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve që zhvillohen jashtë kornizës ligjore. Ky objektiv kërkon mbështetje të vazhdueshme nga agjencitë e tjera qeveritare dhe mund të matet duke ndjekur numrin e bizneseve të regjistruara dhe rritjen e kontrollit në zona të caktuara.
- **Mbrojtja e konsumatorit nga praktikat mashtruese tregtare** - Ky objektiv synon forcimin e rregullave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe për të parandaluar praktikat mashtruese në tregti. Masa e suksesit mund të matet përmes numrit të rasteve të raportuara dhe të zgjidhura, si dhe numrit të inspektimeve dhe ndëshkimeve të aplikuara për shkeljet.
- **Mbrojtja e shëndetit të konsumatorit:** Sigurimi që produktet që ofrohen për konsum nuk dëmtojnë shëndetin e konsumatorëve është një prioritet i vazhdueshëm. Ky objektiv mund të matet përmes inspektimeve të kryera në tregje dhe përmes numrit të ankesave të konsumatorëve të trajtuara.

- **Tregtia e formalizuar:** Mbështetja e tregtisë formale është kyçe për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e transparencës. Ky objektiv mund të monitorohet përmes rritjes së numrit të bizneseve të licencuara dhe regjistruara në sistemet përkatëse

PLANI I PUNËS I INSPEKTORËVE TË TREGUT			
Objektivat	Aktivitetet kryesore	Nën aktivitete	Institucionet /Drejtoritë e përfshira
Mbrojtja e konsumatorëve	Mbrojtja e personave nën moshën 18 vjeçare nga shitja e pijeve alkoolike dhe duhanit. Kontrollimi i vendosjes së çmimeve, si dhe përputhshmëria e çmimeve të deklaruar në raft me çmimin e faturuar. Aktivitet në biznese, përmes të cilave i mundësohet konsumatorit të pajiset me fatura ose kupona fiskalë. Respektimi i garancioneve të produkteve. Kontrollimi i karakteristikave të produkteve përmes certifikatave, deklarimit dhe etiketimit. Vendosja e flamujve sipas origjinës së mallrave	Inspektimi i pompave të derivateve (leja, vulosja, bazhdarimi, etj.). Inspektimi i barnatoreve lidhur me respektimin e orarit të punës, kontrollimin e faturave, çmimeve, flamujve të origjinës, etj. Inspektimi i produkteve në zbritje të deklaruar. Inspektime në furra buke, restorante dhe barkafe. Kontrollimi i marketeve ushqimore për mallra me afat të skaduar, për vendosjen e çmimeve, deklaratës, vendit të origjinës. Inspektime për respektimin e orarit të punës.	MINT (Zyra për mbrojtjen e konsumatorit)
Afatet kohore	Detyra të përhershme gjatë vitit	Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor	

Luftimi i tregtisë informale dhe konkurrencës së padrejtë tregtare	Regjistrimi i biznesit. Verifikimi i kushteve minimale teknike dhe pajisja e subjekteve me pëlqim për të ushtruar veprimtari biznesore. Origjina e mallit dhe mbajtja e evidencës. Kontrollimi i automjeteve transportuese që bartin mallëra për tregti. Kontrollimi i shitësve ambulantiv që bartin mallra për tregti. Luftimi i aktiviteteve të paligjshme (Lojërave të fatit etj.)	Inspektimi i autolarjeve, auto parkingjeve, auto salloneve, salloneve të ondulimit. Inspektimi i subjekteve prodhuese, shërbyese, tregtare.	Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës
---	---	---	---

Afatet kohore	Detyra të përhershme gjatë vitit	Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor	
Siguria e përgjithshme e produkteve	Sekuestrimi dhe asgjësimi i produkteve të pasigurta në treg. Kontrollimi i deklaracionit të mallit në produkte. Udhëzimet e përdorimit të produkteve në gjuhën zyrtare; Fletë garancionet në gjuhën zyrtare;	Kontrollimi i shitjes së fishekzjarrëve në dyqane të licencuara. Kontrollimi i subjekteve afariste në të cilat ushtrohet shitja e mallrave me pakice. Inspektimi i tregtisë së duhanit Kontrollimi i produkteve ushqimore për skadim të afatit të përdorimit, vendosjen e çmimeve, deklaracionin, origjinën e mallrave, në zonën urbane dhe rurale. Inspektime për respektimin e orarit të punës	
Afatet kohore	Detyra të përhershme gjatë vitit	Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor	

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Plani i punës në sektorin e komunikacionit për vitin 2026 do të bazohet në ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që trajtojnë aspekte të ndryshme në sektorin e komunikacionit.

Objektivat kryesore për sektorin e komunikacionit në planin e punës për vitin 2026:

- Shtrirja e operatorit për transport të udhëtarëve në të gjitha zonat rurale,
- Rritja e nivelit të sigurisë në transport.

PLANI I PUNËS I INSPEKTORIT TË KOMUNIKACIONIT		
Objektivat	Aktivitetet	Institucionet/Drejtoritë e përfshira
Mbikëqyrja dhe inspektimi i operatorëve për bartjen e udhëtareve	Kontrollimi i operatorëve nëse janë të regjistruara pranë ministrisë përkatëse për këtë veprimtari. Verifikimi i lejes-licencës së punës nga organi kompetent për zhvillimin e kësaj veprimtarie. Kontrollimi i rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga organi i autorizuar dhe sa i përmbahen rendit të udhëtimit, sa respektohet koha dhe vendi i nisjeve. Kontrollimi për vijat e regjistruara dhe mbajtjes së rregullt. Kontrollimi për çmimet e vërtetuara dhe të vendosura në vendin e paraparë. Kontroll mbi respektimin e obligimit ligjor për dëshminë-biletën e udhëtimit.	Policia e Kosovës/ Sektori i Trafikut Rrugor
Afatet kohore	Inspektim çdo tre muaj	

Inspektimi i vend-parkingjeve	Sinjalizimi i trafikut në parkingje publike dhe mënjanimi i mangësive brenda afatit të caktuar. Inspektimi i gjendjes teknike të parkingjeve publike dhe mënjanimi i mangësive brenda afatit të caktuar, përmes menaxherit. Inspektimi i ndërtimit, rregullimit dhe pajisjeve të parkingjeve, në harmoni me aktet e Administratës Komunale. Inspektimi i parkingjeve publike në aspektin e sigurisë në trafik dhe, në bazë të provave të nxjerra nga organi përkatës, urdhërimi i përmirësimit të gjendjes për sigurinë e pjesëmarrësve në trafik.	DSHP
Afatet kohore	Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht	
Mbikëqyrja inspektuese e linjave të autobusëve dhe taksive (për leje pune dhe licensa)	Inspektimi i subjekteve afariste (kompanitë e transportit të udhëtarëve) për respektimin e rendit të udhëtimit në relacionet urbano-periferike. Kontrolli i radio-taksive dhe auto-taksive. Inicimi i procedurave gjyqësore pranë organeve kompetente për kundërvajtjet e konstatuara.	Policia e Kosovës
Afatet kohore	Aktivitet i përmuajshëm	
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Monitorimi i rrugëve dhe pajisja e tyre me sinjalistikë përkatëse. Krijimi i rrugëve njëkahore, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi në qytet dhe të shmanget ngarkesa nga mjetet motorike.	DSHP
Afatet kohore	Monitorim i vazhdueshëm gjatë vitit	

SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Metodologjia e ndjekur për përpilimin e këtij plani merr në konsideratë ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit.

Objektivat kryesore për mbrojtjen e mjedisit në planin e punës për vitin 2026 janë:

- Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave mjedisore dhe natyrore në territorin e komunës.
- Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes dhe çrregullimeve mjedisore.
- Forcimi i zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kushteve të përcaktuara me leje përkatëse.
- Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve publike komunale që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
- Rritja e nivelit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies ndaj shkeljeve mjedisore.
- Ngritja e vetëdijes dhe rritja e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mjedisit.
- Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore në komunë.

PLANI I PUNËS I INSPEKTORIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT		
Objektivat	Aktivitetet	Institucionet e përfshira
Mbrojtja e ajrit	Verifikimi i aktiviteteve ndotëse. Parandalimi i aktiviteteve të djegies së mbeturinave nga goma, letra, tekstile dhe materiale të tjera që i ndalohen me ligj. Zhvillimi i takimeve me biznese dhe komunitetin për parandalimin e dukurive të zjarrevënieve dhe djegies së mbeturinave. Mbikëqyrja e lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Stimulimi i përdorimit të mjeteve të transportit që nuk ndotin ajrin – biçikletat, trotinetët elektrikë. Inspektime në industrinë prodhuese që gjatë zhvillimit të veprimtarisë lëshojnë gazra ndotëse.	Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Njësia e Policisë/Skenderaj Njësia e Zjarrëfiksave Bizneset Bashkësit lokale dhe lagjet
Mbrojtja e ujit	Inspektimi i lumenjve dhe rrjedhave të tij mbi tokësore – përroskave. Mbikëqyrja e lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Zhvillimi i aktiviteteve vetëdijësuese për ruajtjen e ujërave nga ndotja. Aksione për parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm.	DSHP DUMA DKA
Mbrojtja e tokës	Inspektimi i zonave industriale, zonave të ndërtimeve dhe zonave të tjera ku aktiviteti njerëzor ka ndikim. Aktivitetet e pastrimit dhe fushatat për ruajtjen e hapësirave publike dhe private nga ndotja.	Bizneset në Skenderaj DUMA DSHP KRM Uniteti

PLANI I PUNËS I INSPEKTORIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT		
Objektivat	Aktivitetet	Institucionet e përfshira
Mbrojtja e ajrit	Verifikimi i aktiviteteve ndotëse. Parandalimi i aktiviteteve të djegies së mbeturinave nga goma, letra, tekstile dhe materiale të tjera që i ndalohen me ligj. Zhvillimi i takimeve me biznese dhe komunitetin për parandalimin e dukurive të zjarrevënieve dhe djegies së mbeturinave. Mbikëqyrja e lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Stimulimi i përdorimit të mjeteve të transportit që nuk ndotin ajrin – biçikletat, trotinetët elektrikë. Inspektime në industrinë prodhuese që gjatë zhvillimit të veprimtarisë lëshojnë gazra ndotëse.	Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës Njësia e Policisë/Skenderaj Njësia e Zjarrëfiksave Bizneset Bashkësit lokale dhe lagjet
Mbrojtja e ujit	Inspektimi i lumenjve dhe rrjedhave të tij mbi tokësore – perroskave. Mbikëqyrja e lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Zhvillimi i aktiviteteve vetëdijësuese për ruajtjen e ujërave nga ndotja. Aksione për parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm.	DSHP DUMA DKA
Mbrojtja e tokës	Inspektimi i zonave industriale, zonave të ndërtimeve dhe zonave të tjera ku aktiviteti njerëzor ka ndikim. Aktivitetet e pastrimit dhe fushatat për ruajtjen e hapësirave publike dhe private nga ndotja.	Bizneset në Skenderaj DUMA DSHP KRM Uniteti

	Mbikëqyrja e lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Përcjellja e nivelit të pastërtisë në zonën urbane dhe në zonat rurale. Monitorimi i urdhëresave për bizneset për mirëmbajtjen e hapësirave përpara objekteve ku ushtrojnë veprimtaritë. Mbikëqyrja e hapësirave të gjelbra: parqeve të qytetit dhe parqeve të komplekseve banesore. Fushata në shkolla për edukim mjedisor dhe diskutime mbi problemet mjedisore, duke kërkuar zgjidhje. Aktivitetet për mirëmbajtjen e oborreve të shkollave, pastrim dhe mbjellje. Monitorimi i aktiviteteve të Kompanisë Regjionale për Menaxhimin e Mbeturinave në Skenderaj për aktivitete me ndikim në mjedis. Monitorimi i aktiviteteve mjedisore të NPL Eko Natyra SH.A. Inspektime për pastërtinë dhe mirëmbajtjen e kanaleve dhe pusetave të ujërave atmosferike. Inspektime për rrjedhje të ujërave të zeza	EKO Natyra DKA
Mbikëqyrja e nivelit të administrimit të mbeturinave	Mbikëqyrja e procesit të menaxhimit të mbeturinave të amvisërisë, mbeturinave inerte dhe mbeturinave natyrave të tjera. Inspektime periodike në deponinë për mbeturina inerte. Inspektime në vende ku bëhen hedhje të paligjshme të mbeturinave, aktivitete për heqjen e mbeturinave për të siguruar që mbetjet të hidhen aty ku duhet, dhe mbikëqyrja e këtyre zonave të transformuara. Inspektimi i operatorëve ndërtimor për verifikim të lejes mjedisore dhe raportit të	DSHP KRM UNITETI NPL EKONATYRA

Mbrojtja e biodiversitetit dhe peisazheve natyrore	Mbikëqyrja dhe inspektimi i shfrytëzimit të komplekseve pyjore. Mbikëqyrja e veprimtarisë së gjuetisë dhe peshkimit, dhe parandalimi i zhvillimit të tyre në mënyrë të dëmshme për ekosistemet. Inspektimi i zonave me florë dhe faunë të mbrojtur.	
Afatet kohore	Aktivite të vazhdueshme gjatë vitit	

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Objektivat kryesore të planit të punës në sektorin e shërbimeve publike për vitin 2026 janë:

- Parandalimi i uzurpimit të paligjshëm i pronës publike, hapësirave publike si rrugëve, shesheve, trotuareve dhe hapësirave të gjelbra komunale.
- Monitorimi dhe parandalimi i kycjeve ilegale në rrjetin e kanalizimit publik, monitorimi i ndërhyrjeve në rrugë publike pa leje, në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.

PLANI I PUNËS I INSPEKTORIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE		
Objektivat	Aktivitetet	Institucionet e përfshira
Kontrolli rreth shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.	Kontrolle inspektuese. Aksione për lirimin e sipërfaqeve publike. Inspektime të rrugëve, inspektime të trotuareve dhe sipërfaqeve të tjera publike. Pastrimi i rrugëve nga bora-qarkullim i lirshëm i komunikacionit.	DSHP Policia e Kosovës
Vendosja konform ligjeve për mbishkrimet, panot dhe tabelat reklamuese	Kontrolle inspektuese operatorëve ekonomik. Respektimi i afateve të dhëna me procesverbale. Largimi i tabelave reklamuese nga hapësirat publike	
Inspektime në Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit/Dega Skenderaj	Furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm Mbikëqyrje rreth mirëmbajtjes dhe pastrimit e rrjetit të ujësjellësit, kanaleve dhe pushtave të ujërave të zeza si dhe mirëmbajtjen dhe pastrimin e rezervuarëve të ujësjellësit të qytetit.	KRU Skenderaj DSHP

Inspektime në kompanitë kontraktuese në infrastrukturë rrugore	Mbikëqyrja e rrjetit elektrik në punimin e rrugëve dhe trotuareve, rrjetit të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit, rrjetit të internetit.	DSHP DUMA KRU Skenderaj KEDS
Afatet kohore	Aktivitete të përhershme	

SEKTORI I NDËRTIMIT

Objektiva kryesore e planit të veprimit në sektorin e ndërtimit për vitin 2026:

- Parandalimi i ndërtimit ilegal,
- Mbikëqyrja e zbatimit të lejeve të ndërtimit,
- Kontrolli i përputhshmërisë së projekteve me standardet dhe rregulloret teknike.

PLANI I PUNËS I INSPEKTORIT TË NDËRTIMIT		
Objektivat	Aktivitetet	Institucionet e përfshira
Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje	Inspektimi i objekteve ndërtimore në të gjitha fazat e ndërtimit. Plotësimi i formularëve standard për çdo fazë të ndërtimit ,gjatë inspektimeve në vend ndërtim. Inspektimi përfundimtarë i ndërtimit të objektit me leje ndërtimi dhe plotësimi i formularit standardë. Kompletimi i lëndës për çdo objekt ndërtues dhe mbajtja e një kopje të formularit standardë.	DUMA Policia e Kosovës DGJK
Konservimi, rrënimi i ndërtimeve dhe mbindërtimeve pa leje	Ndalimi i punimeve ndërtimore. Nxjerrja e vendimit për rrënim.	Policia e Kosovës, Operatori Kontraktues
Kontrollimi i objekteve të vjetra nga aspekti i mirëmbajtjes	Inspektimi periodik i të gjitha objekteve të vjetra dhe konstatimi nëse ato paraqesin rrezikshmëri për banorët përreth apo kalimtarët e rastit. Konservimi i objekteve të vjetra.	Mirëmbajtësit e objekteve
Afatet kohore	Aktivitet të përhershme gjatë vitit	

BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMUNALE DHE INSTITUCIONET TJERA

Për arritjen e të gjitha objektivave të përcaktuara me këtë plan pune, është shumë e nevojshme të kemi një bashkëpunim të ngushtë me institucionet kompetente, të cilat do të ndihmonin arritjen e rezultateve konkrete në angazhimet tona inspektuese.

Sikurse në vitet paraprake, do të vazhdojmë të kemi një bashkëpunim korrekt me Policinë e Kosovës, inspektorët e institucioneve tjera qendrore, MMPHI, MINT, kompanitë publike dhe ato private me të cilat Komuna e Skenderajt ka kontratë, si dhe me të gjitha institucionet e tjera me të cilat kemi ndërlidhje kompetencash dhe nevojë bashkëpunimi.

Përveç kësaj, do të inkurajojmë shkëmbimin e informacionit dhe të të dhënave relevante në kohë reale, organizimin e takimeve periodike koordinuese dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta që ndikojnë në përmirësimin e zbatimit të ligjit dhe standardeve komunale.

Ky bashkëpunim do të rritet gjithashtu në shërbim të interesave të përgjithshme të qytetarëve të Skenderajt, duke përfshirë ngritjen e vetëdijes qytetare, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e mjedisit, pronës publike, konsumatorit dhe sigurisë në transport.

Dhjetor, 2025

Skenderaj

Drejtori i Inspektionit

Valon Haliti
